

Mevledin MUSTAFI, PhD¹

UDC: 342.725:341.24

**FAKTORËT, MOTIVET, SHKAQET E VEPRAVE TË KRIMINALITETIT
DOGANOR DHE NDËRLIDHSHMËRIA E TYRE NË
KONTRABANDIMET DOGANORE NË REPUBLIKËN E
MAQEDONISË SË VERIUT**

**ФАКТОРИТЕ, МОТИВИТЕ, ПРИЧИНИ НА ЦАРИНСКИТЕ
КАЗНИВИ ДЕЛА И НИВНАТА ПОВРЗАНОСТ ВО ЦАРИНСКОТО
КРИУМЧАРЕЊЕ ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

**FACTORS, MOTIVES, CAUSES OF CUSTOMS CRIMINAL
OFFENSES, AND ITS INTERCONNECTEDNES IN CUSTOMS
SMUGGLING IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA**

Abstract

The study of mechanisms of prosecution and sanctions for crimes in the field of customs is of theoretical and practical interest as well as to understand their features, character identification and perspectives. It remains to better understand the differences in the processing of crimes in the field of customs with those in other fields. To better understand the specificity of the mechanisms of prosecution and sanctions in customs law, it is necessary to recall the historical mutations, which have given customs, for a long time, extraordinary powers, in order to ensure efficiency and speed of sentencing for customs offenses. The customs service is an authority of the state, which has the task of collecting import duties, as well as controlling the means and goods entering and leaving the customs territory of that country. It was born and raised along with the state. Moreover, it can not be considered at all wrong if it is thought that customs was born together with trade. On the other

¹ University professor in the field of customs and Senior Superior in MIA-Skopje, 2022. Email: mevledin_mustafi@hotmail.com

hand, along with customs and the request for collection of customs duties, there must have been a tendency not to pay certain duties, which nowadays we call commercial smuggling. In order to prevent and fight the crime of smuggling, it was necessary to draft a package of legal norms, which provide for concrete figures of criminal offenses of smuggling. Over time history has taken its toll. The role of the customs service has changed significantly, as a result of dual evolution, including the increasing globalization of trade and various factors, such as terrorist attacks, illegal trafficking, organized crime.

Keywords: *Crime, customs offenses, Criminal Code, criminal sanctions, globalization of trade, risks, customs barriers, smuggling, types of smuggling offenses, fight against criminal activities, crime, etc.*

Kriminaliteti si modalitet shqetësues për shoqërinë bashkëkohore

Secili krim individual është përgjigje në situatën specifike të personalitetit. Ai është një tërësi psikologjike dhe emocionale e komplikuar pa masë, e cila iu nënshtrohet presioneve të jashtme komplekse dhe të pa fund. Kriminaliteti përfaqëson një milion përgjigje të tilla. Të kërkosh shkaqet e krimit vetëm në motivet njerëzore do të thotë të rrezikosh që ato të zhdukën në pluhurin e padepërtueshëm të psikës njerëzore. Ka krime aq irracionale, të paparashikuara dhe eksplozive dhe aq të papërshtatshme për t'i analizuar dhe shpjeguar sa që vështirë është të pengohen dhe është vështirë për tu mbrojtur nga to, sikurse nga tërmeti apo valët e baticës. Shkaktarët e krimit pra janë të shumtë, të ndërthurur dhe të fshehtë. Për ta kuptuar këtë, individi duhet të grumbullojë të dhënat mbi masën dhe trendët e krimit, të përcaktojë “çmimin e krimit”, t'i studiojë dhe analizojë kushtet e jetës atje ku ai shpërthen, t'i identifikojë kriminelët dhe viktimat e tyre, të konstatohet qëndrimi i shoqërisë ndaj krimit.² Studimet tregojnë një rritje të ndjeshme të tij dhe nivele të ulëta të raportimit në polici. Nga ana tjetër, krimi i organizuar po bëhet gjithnjë e më shumë i sofistikuar. Profesionalizimi i veprimeve të grupeve kriminale vihet re në llojin e aktiviteteve që kryejnë, në strukturën e grupeve dhe në ndarjen e territorialeve të zonave të veprimtarisë së tyre. Por ajo që e dallon krimin në Evropë është ndërkombëtarizimi i tij. Tashmë dihet se

² Bashkim Dr.Selmani, “Kriminologjia dhe penologjia”, f. 12-14. Kolegji “Fama” - Prishtinë, 2014.

krimi kryhet nga grupe vendëse që kanë pushtet në zonën ku veprojnë, nga grupe heterogjene vendëse dhe të huaj ose nga grupe të huaja.³

1. Shkaqet e krimit dhe kriminalitetit, pasojat për qytetarët dhe shoqërinë

Shkaku i krimit apo kriminalitetit mund të përkufizohet si ndryshim objektiv real i cili sjell deri te një dukuri tjetër reale, kurse e cila përsëri në rrjedhën e mëtejme të lëvizjes permanente në natyrë dhe shoqëri deri te ndryshimi i mëtejme dhe kështu gjithnjë deri në pafundësi. Ndërlikueshmëria e kriminalitetit të cilin e paraqitëm në mësimet e mëparshme përshkruan më së miri ndërlikueshmërinë e problemit me të cilin ballafaqohemi me rastin e shqyrtimit të shkaqeve të kriminalitetit. Studimin më kompleks për procesin e lindjes së kriminalitetit dhënë përmes sistemit të tij të etiologjisë kriminale, i cili atë sistem e paraqet përmes dy degëve: 1) Degës së Etiologjisë Ekzogjene dhe 2) Degës së Etiologjisë Endogjene. Sistematizim të ngjashëm hasim edhe te autorët tjerë. Përcaktimi i vëllimit dhe intensitetit të veprimit të faktorëve kriminogjene, pas njohjes me përmbajtjen e tyre, paraqet hapin e ardhshëm të rëndësishëm në elaborimin e tematikës nga fusha e etiologjisë së kriminalitetit. Kur diskutohet për vëllimin e faktorëve kriminogjene, këtu, në këtë kuptim, dallojmë dy grupe më të mëdha. Grupi i parë është ai i cili përpiket që aktivitetin kriminal ta shpjegojë përmes ndikimit të një faktori bazik dhe kjo na paraqitet me emrin qasja moniste apo monokauzale, gjegjësisht interpretim monofaktorial. Interpretimet e këtilla kanë qenë të përfaqësuara edhe në fazat e më hershme të zhvillimit të kriminologjisë pozitiviste. Grupi i dytë, nisët nga pikëpamja se për interpretimin e lindjes së kriminalitetit vëmendjen duhet përqendruar te ndikimi i shumë faktorëve të ndryshëm. Këto interpretime mund të quhen vështirime pluraliste të etiologjisë kriminale dhe i përkasin qasjes moderne të studimit, analizës së kushteve dhe shkaqeve të lindjes së kriminalitetit. Në anën tjetër në raport me llojin e ndikimit, mund të thuhet se edhe këtu ekzistojnë dy mënyra të qasjes.⁴

³ Bouloc Bernard, “Kompetencat e punonjësve doganorë”, Revista Shkencore, f. 143 Krimi - 1996, f. 143.

⁴ Mevledin Dr. Mustafi “Mashtimet doganore dhe kontrabandimi me keqpërdorimin e dokumentacionit doganor gjatë importit të mallrave”, disertacioni i doktoraturës, Universiteti “Shën Kliment i Ohrit”, 2013.

2. Etiologjia e kriminalitetit ka dy sfera të cilat organikisht janë të ndërlidhura

Etiologjia e kriminalitetit ka dy sfera të cilat organikisht janë të ndërlidhura. Njëra ka të bëjë me studimin e kriminalitetit nga këndvështrimi i caktuar i strukturës dhe kulturës shoqërore, kushteve të caktuara jetësore, ndikimi i faktorëve të ndryshëm kriminogjenë, ndikimi i botë-kuptimeve të ndryshme mbi vlerat dhe konflikti i vlerave dhe çështjeve tjera të ngjashme. Kjo quhet etiologji ekzogjene. Tjetra studion procesin e formimit të personalitetit në drejtim të kryerjes së aktivitete delikuede dhe kriminale apo thënë më saktë studion procesin e “kriminalizimit”, i cili duhet të na sjellë deri te njohuria se përse disa persona kryejnë vepra penale dhe si është e mundur që kushtet e caktuara të një kulture, nga ata, të krijojnë kriminel dhe delinkuent. Në kuadër të kësaj studiohet ndikimi i elementeve dhe vetive personale në sjelljen kriminale. Kjo është sfera e të ashtuquajturës etiologji endogjene. Qasja e këtillë quhet pluralistike apo multifaktoriale dhe si e tillë për herë të parë na paraqitet në rreshtat e Enriko Ferrit, i cili konsiderohet edhe themelart i këtij studimi në etiologjinë kriminale duke i vënë vend të posaçëm veprave të kriminalitetit doganor-kontrabandimit doganor. Pas shfaqjes së këtij orientimi multifaktorial paraqitet edhe interpretimi mbi intensitetin e veprimit të disa faktorëve apo të disa grupe faktorësh. Këtu gjithashtu mund të konstatohet edhe paraqitja e mendimeve të ndryshme, por përsëri mund të thuhet se pjesa dërmuese e autorëve, në fund të fundit, pajtohen për të ashtuquajturin ndikim zhvillimor të faktorëve të ndryshëm me mundësinë e ndarjes së faktorëve me ndikim më të madh në rastet e caktuara konkrete.

3. Ndikimi i faktorit individual dhe faktorëve të jashtëm kriminogjenë në shtytjen e kriminalitetit doganor, analizë e përgjithësuar

Vërehet gjithashtu se në çdo situatë konkrete është e nevojshme që pjesën e vet ta kenë si faktorët individualë ashtu edhe faktorët e jashtëm. Pikërisht kjo pikëpamje është edhe më e përfaqësuar, sipas së cilës çdo rast individual duhet të shqyrtohet dhe studiohet ndaras dhe vetëm pas analizës sistematike mund të konstatohet prezenca i ndonjë faktori i cili ka karakter më të madh ndikues. E dyta, dega e kriminologjisë, e pandashme nga etiologjia është fenomenologjia, gjegjësisht grupi i studimeve shkencore mbi fenomenologjinë e kriminalitetit. Kështu, pohohet

se kjo sferë e posaçme e kriminologjisë studion dhe analizon format e dukurive, strukturën, paraqitjen strukturale dhe dinamikën e kriminalitetit. Ndonëse këto dy degë të kriminologjisë, në shikim të parë na paraqiten të ndara, megjithatë këto assesi nuk duhet shikuar si të ndara, para së gjithash për shkak të objektit të tyre të përbashkët të studimit me të cilin ato merren, gjegjësisht për shkak të qëllimit të përbashkët të cilin ato duhet ta përmbushin. Ai qëllim ka të bëjë me kontributin e madh të cilin ato duhet ta japin, përmes studimit sa më të thuktë shkencor, në luftën e gjithmbarshme shoqërore kundër kriminalitetit doganor.⁵

Vlen të nënvizohet se klasifikimi i kontrabandës doganore nëpërmjet kalimit, zhvendosjes, dhe kontrabandës nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore kanë disa veçori, që shpjegohen me specifikën e veprimtarive të tilla. Me qëllim që t'u jepet një vlerësim i drejtë veprimtarive me rrezikshmëri shoqërore, të kryera në sferën e çështjeve doganore, nëpunësit e organeve doganore, avokatët dhe akuza, madje edhe gjykata, duhet t'u drejtohen si normave penale, ashtu edhe atyre doganore, administrative, tatimore, financiare dhe degëve të tjera të së drejtës.

4. Objekti i kriminalitetit doganor dhe sfidat e veprimit në luftimin e tij

Kontrabandë me mallrat e ndaluara janë: Objekti i drejtpërdrejtë, dhe sfidues përmes të cilit me veprime të caktuara siç janë: Kontrabandimi me mallrat e licencuara, kontrabanda e mallrave për të cilat është e parashikuar pagesa e akcizës, kontrabanda e vlerave kulturore, mos deklarimi në kufi i të hollave dhe sendeve me vlerë, kontrabanda e mallrave me regjim të ndërmjetëm, paraqesin objektin e krimit i cili nga kryerësit e caktuar pas veprimeve më lartshënuara me ndihmën e ndërmjetësuesve të cilët merren me veprimtari doganore siç janë punëtorët e shërbimit doganor-doganierët, shpeditoret, policët doganorë u mundësohet realizimi i profitit të lartë jashtë-ligjor ku më pas të njëjtit përmes tregtimit, tjetërsimit dhe transportit të mallrave të cilët janë kontrabandë vazhdojnë me proceset e mëtutjeshme të kriminalitetit. Asnjë mënyrë e përshkrimit të krimit nuk e skicon atë në mënyrë të mjaftueshme”. Pra, në elaborimet në vijim do të sqarojmë arsyetimet e teorive

⁵ Mevledin Dr.Mustafi “Mashtrimet doganore dhe kontrabandimi me keqpërdorimin e dokumentacionit doganor gjatë importit të mallrave”, disertacioni i doktoraturës, Universiteti “Shën Kliment i Ohrit”, 2013.

mbi shkaqet e kriminalitetit në mënyrë që t'i japim një kontribut qasjes sa më serioze ndaj të gjitha hulumtimeve apo analizave të cilat merren me këtë çështje.⁶Një tendencë e krimit të organizuar në Evropë është seleksionimi i vendeve si vende të përshtatshme për të zhvilluar aktivitete krimino gjene e me theks të veçantë në aspektin e veprave të kriminalitetit doganor duke kontrabanduar në forma dhe mënyrat më të sofistikuar përmes individëve të strukturuar në grupe mirë të organizuar kriminale të cilët përmes disa veçorive të posaçme që kanë në funksionalitetin e tyre kanë diktuar ndryshime të shpeshta dhe të shumta të politikës kriminale në shumicën e vendeve të Evropës, veçanërisht në Vendet Ballkanike të cilëve po u përgjigjen edhe nismat e shumë shteteve të Evropës dhe të botës në tërësi. Organizatat e ndryshme ndërkombëtare po studiojnë krimin e organizuar, format, motivet dhe shkaqet e shfaqjes së tij dhe mënyrën e luftimit. Një tendencë e krimit të organizuar është edhe ristrukturimi i iniciativave kriminale në përputhje me ndryshimet e ekonomisë botërore, dhe rregullat e funksionimit të saj posaçërisht të ndihmuar nga epoka e krimit të sofistikuar kibernetik i cili ua lehtësoi punën në veprimet e tyre kriminale. Jo vetëm ekonomia botërore por edhe kriza e fundit ekonomike botërore shpie tek dyshimi i mënyrës së funksionimit botëror në ngulfatje në forma dhe mënyra që akoma është në studim e sipër të shfaqjes së krizës botërore. Jo vetëm ekonomia botërore, por edhe grupet kriminale shfrytëzojnë lehtësitë që ofrojnë teknologjitë e reja dhe teknikat e komunikimit elektronik-kibernetik.⁷

5. Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shikuar në këtë prizëm, Nenet 278; Neni 2278-a dhe Neni 278-b i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kodit Doganor nuk përcaktojnë në mënyrë të thuktë mënyrat e shmangies nga pagesat

⁶ Kriminologjia është shkencë e cila analizës dhe studimit të dukurive të caktuara iu qaset në mënyrë interdisiplinare, multidisiplinare dhe multimetodologjike. Kriminologjia gjithashtu është shkencë edhe fenomenologjike edhe kauzale-gjenetike, sepse studion format e paraqitjes së objektit të saj të studimit dhe hulumton shkaqet e atyre dukurive duke i përcjellë ato me zhvillimin e vet. Kriminologjia nuk është shkencë juridike, por shkencë mbi përvojat, (shkencë empirike), e cila shërbehet me rezultatet e hulumtimeve empirike dhe me të arriturat e empirizmit.

⁷ Berr Claude - Jean, TREMEAU Henri, "E drejta doganore komunitare dhe kombëtare", Edicioni i 7-të, Editori Economica, Paris – 2006, 28.

⁸ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut- Nenet 278; Neni 2278-a dhe Neni 278-b.

doganore.⁸ Përgjegjësia fillon direkt apo menjëherë me fillimin e veprimtarisë, e cila nënkupton - përgjegjësia, qëndron në kalimin jashtë zonës doganore apo në dhe nga zona doganore me mashtrim, fshehje të mallit objekt kontrabande, kalimi jashtë orarit ose forcërisht. Shmangia mund të shprehet në fshehjen e mallit, që kalon në uljen e vlerës së mallit, në paraqitjen e informacionit jo të besueshëm mbi përkatësinë apo destinacionin, si në rastin e mospagimit të plotë apo të pjesshëm të pagesave doganore, fakt ky që tashmë të tërheq vëmendjen si mashtrim doganor. I njohur në praktikën ligj-zbatuese se për shmangiet, në të shumtat e rasteve, veprohet duke mos deklaruar apo duke deklaruar të dhëna jo të vërteta false, domethënë mënyra të cilat dalin apo shprehen edhe në cilësinë e simptomave të anës objektive të kalimit kontrabandë përmes kufirit doganor të mallrave e mjeteve të tjera. Pyetja që shtrohet për çështjen objekt studimi është se ka kritere për ndarje të krimeve të kontrabandës nëpërmjet kalimit dhe asaj nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore? Dallimet midis kontrabandës, kalimit, zhvendosjes së mallrave në dhe nga kufiri shtetëror Nëse i referohemi dispozitave të Kodit Penal që kanë të bëjnë me kontrabandën, vërejmë se kontrabanda nëpërmjet kalimit, zhvendosjes së mallrave në dhe nga kufiri shtetëror ndryshon nga kontrabanda nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore në të katër elementët përbërës të krimit: objektit ana objektive, subjektit anës subjektive.

6. Objekti i drejtpërdrejtë i kontrabandës përmes kalimit, zhvendosjes së mallrave kontrabandë

Objekti i drejtpërdrejtë i kontrabandës përmes kalimit, zhvendosjes së mallrave kontrabandë është rregull i vendosur apo i përcaktuar për kalimin e mallrave, mjeteve transportuese dhe i objekteve të tjerë përmes kufirit shtetëror doganor. Objekti i drejtpërdrejtë i kontrabandës përmes shmangies nga pagesat doganore është sfera financiare, detyrimet e importit dhe eksportit ose marrëdhëniet shoqërore për shkak të formimit apo grumbullit në buxhetin e shtetit të të ardhurave financiare dhe të rregullit të përcaktuar për realizimin e pagesave doganore. Mjet i kontrabandës është kalimi joligjor, nëpërmjet kufirit doganor të mallrave dhe objekteve të tjerë, ndërsa mjet i shmangies janë pagesat doganore Mjet i kontrabandës është kalimi joligjor, nëpërmjet kufirit doganor të mallrave dhe objekteve të tjerë, ndërsa mjet i shmangies janë pagesat doganore. Në këtë mënyrë, ndryshimi dhe mospërputhja e objekteve dhe mjeteve të kontrabandës, shmangies nga pagesat doganore, lejojnë apo bëjnë të mundur që këto krime të veçohen nga njëri-tjetri. Në shqyrtimin

e çështjeve të mësipërme është i rëndësishëm fakti, se në rastin e kontrabandës përmes kalimit, duke mos deklaruar ose duke deklaruar ndryshe nga ajo çfarë influencon apo ndikon në marrjen e vendimit për lejimin e kalimit të mallrave nëpërmjet kufirit doganor, mund të jetë mënyrë për shmangien nga pagesat doganore tërësisht apo pjesërisht.

7. Kontrabanda përmes kalimit, zhvendosjes dhe kontrabanda nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore

Kontrabanda përmes kalimit, zhvendosjes dhe kontrabanda nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore, megjithëse hyjnë në grupin e krimeve doganore, në esencë kanë përbërje të ndryshme të kriminale, ku asnjëra nuk përjashton tjetrën. Analiza e praktikës hetimore dhe gjyqësore e përdorur për kualifikimin e krimeve, gjatë pranisë së simptomave të kontrabandës dhe shmangies nga pagesat doganore, si edhe gjatë trajtimit të mendimeve apo opinioneve të juristëve, na lejon të konstatojmë faktin problematik të interpretimit të veprimtarive të trajtuara më sipër. Ndodh rëndom që gjyqtarët të bëjnë Veprat penale në fushën e doganave gabime tipike, gjatë zbatimit të kualifikimeve për krimet, gabime këto që lidhen me mospërcaktimin e saktë të veprimit të kryer, nga veprimi i mbetur në tentativë, të objektit të kontrabandës dhe të objektit të krimit nëpërmjet shmangies apo edhe të përmbajtjes së anëve objektive e subjektive të veprimtarive në fjalë. Aq më shumë që, duke mos kuptuar ndryshimet në këto vepra penale të fushës doganore, vazhdon të ketë qëndrime të ndryshme si në rrafshin teorik doktrinar, ashtu edhe në praktikën gjyqësore lidhur me përcaktimin e figurës së krimit të kontrabandës, si figura krimi formale apo materiale të veprës kontrabandë të konsumuar apo të hipotezave të mbetjes së krimit në fazën e tentativës. Është karakteristikë për krimet e kryera deri ose mbas kalimit të mallrave përmes kufirit doganor, d.m.th. në doganat e brendshme apo në kushtet e vendosjes së mallrave në procedura të veçanta doganore se si ato kryhen dhe cilat procese juridike aplikohen.

8. Kontrabandimi si qëllim i kalimit të paligjshëm dhe ikjes së pagimit të taksave doganore

Sipas qëllimit: Qëllimi i kontrabandës është kalimi i paligjshëm i pagimit të taksave doganore. Në këtë mënyrë, kontrabanda dhe shmangia nga pagesat doganore nuk përputhen si në objekt, ashtu edhe në qëllim. Sipas subjektit: Në të vërtetë, rrethi i subjektit të kontrabandës përmes

kalimit nuk është përcaktuar si i tillë. Subjekt kontrabande mund të jetë cilido person fizik i përgjegjshëm që ka arritur moshën 18 vjeç, moshë kjo e mjaftueshme për sigurimin e përgjegjesisë penale, persona në detyrë që kryejnë krime, duke përdorur shfrytëzuar postin për këtë qëllim. Kështu, subjekti i kontrabandës nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore nuk mund të jetë çdo person që bën kalimin e mallrave përmes kufirit doganor, por vetëm një i tillë kur në detyrat e tij hyn edhe ajo e pagesës doganore. Kontrabanda përmes kalimit, nuk i përmban simptoma të tilla të domosdoshme, prandaj jo të gjithë personat, të cilët janë vënë para përgjegjesisë penale për kryerje të kontrabandës, mund t'i nënshtrohen ndjekjes penale për shmangie nga pagesat doganore.

9. Ana objektive-veprimtaria apo aktiviteti, pasoja dhe lidhja shkak-pasojë midis tyre gjatë proceseve të veprimit

Elementi bazë i anës objektive është veprimtaria apo aktiviteti, pasoja dhe lidhja shkak-pasojë midis tyre. Përveç kësaj, rol të rëndësishëm luajnë vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së krimit. Megjithëse, konstruksioni i veprës penale të kontrabandës dhe veprës penale të shmangies nga pagesat doganore janë të ndryshme. Kontrabanda nëpërmjet kalimit, zhvendosjes hyn në krimet me elementë formalë, figura krimi të prera apo formale, ndërsa shmangia nga pagesat doganore ka përbërje materiale. Në rastin e fundit, është e domosdoshme prania apo ekzistenca e pasojave kriminale, në formën e mospagimit të taksave doganore. Moskuptimi i këtij ndryshimi është bërë shkas për qëndrime të ndryshme si nga studiues, ashtu edhe gjatë praktikës gjyqësore. Kontrabanda përmes lëvizjes, zhvendosjes së mallrave nga dhe në kufirin shtetëror mund të kryhet vetëm nëpërmjet rrugës së veprimit. Nëpërmjet rrugës së mosveprimit, kontrabanda është e pamundur të kryhet, sepse duke u nisur nga dispozitat e lartpërmendura në Kodin Penal të RMV-së, ky lloj krimi përfaqëson në vetvete së pari, zhvendosjen apo kalimin përmes kufirit doganor. Kontrabanda përmes shmangies nga pagesat doganore mund të kryhet apo realizohet si nëpërmjet veprimeve, ashtu edhe nëpërmjet mosveprimeve Ndërkohë që kontrabanda përmes shmangies nga pagesat doganore mund të kryhet apo realizohet si nëpërmjet veprimeve, ashtu edhe nëpërmjet mosveprimeve. Për njohjen si fajtor të personit në kryerjen e kontrabandës nëpërmjet lëvizjes është e domosdoshme prania e dy simptomave të domosdoshme në mënyrën e kryerjes së krimit: kalimi i mallrave apo mjeteve të tjera përmes kufirit

shtetëror; ky kalim duhet të shoqërohet ose me shkeljen e rregullave për kalimin përfshi edhe ato të vendosura për kalim në pikat e kontrollit doganor nëpërmjet mashtrimit, përdorimit të dokumenteve false mjete të identifikimit doganor, po ashtu edhe nëpërmjet shkeljes së rregullave të deklarimit, kalimit jashtë kohës së punës apo forcërisht. Gjithashtu, ana objektive e kontrabandës nëpërmjet kalimit ndryshon nga ana objektive e kontrabandës nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore, për vendin dhe kohën e kryerjes së krimit. Në rastin e kontrabandës përmes kalimit të kufirit, del në plan të parë vendi i kryerjes së krimit që, në këtë rast, është kufiri doganor. Një shenjë apo simptomë e tillë, që është vendi, në përbërësit e shmangies nga pagesat doganore, nuk ka. Rëndësi të veçantë ka edhe momenti i përputhjes së kryerjes së krimit me momentin e kalimit apo zhvendosjes përmes kufirit doganor. Në kontrabandën përmes kalimit, këto dy nocione janë identike, pra të barasvlershme.

10. Gjatë kontrabandës përmes shmangieve nga pagesat doganore nuk ekziston një reciprocitet kompakt i tillë

Gjatë kontrabandës përmes shmangieve nga pagesat doganore nuk ekziston një reciprocitet kompakt i tillë. Shmangia nga pagesat doganore mund të kryhet edhe gjatë kalimit të paligjshëm të kufirit, por në rastin kur kalimi bëhet në përputhje me rregullat e caktuara, detyrimi për pagesat doganore lind jo nga momenti i kalimit të mallrave, por nga momenti i dorëzimit, apo dhënies së Deklaratës Doganore (apo dhënies së saj brenda afateve të caktuara), sikurse gjatë kohës së shmangies nga kushtëzimet e vendosura për mallrat në procedura të veçanta doganore. Shmangia nga pagesat doganore mund të bëhet jo vetëm në rajonet e kufirit doganor, por edhe në rajonet e brendshme të vendit, në zonën e veprimtarisë apo aktivitetit të brendshëm të doganave, në të cilat bëhet dokumentacioni i duhur për mallin.⁸

Ndryshime, midis krimit të kontrabandës nëpërmjet kalimit dhe asaj të shmangies nga pagesat doganore, ka edhe për sa i përket anës së tyre subjektive. Në qoftë se shmangia nga pagesat doganore kryhet për qëllime interesi material dhe qëllimi i fajtorit synon t'i përfitojë, duke i mohuar shtetit të drejtën e kufirit dhe, në tërësi, detyrimet e importit dhe eksportit të llogaritura për buxhetin e shtetit, atëherë kontrabanda si një akt kriminal i kryer nëpërmjet kalimit, zhvendosjes mund të realizohet,

⁸ Krime në Fushën e Doganave. Aspekte të Veprës Penale e Kontrabandës Alket Hyseni & Prof.dr. Shamet Shabani, 2014.

duke pasur edhe motive të tjera, që mund të mos kenë karakter interesi pasuror. Gjithashtu, kontrabanda nëpërmjet kalimit të kufirit shtetëror ndryshon edhe nga mënyrat e kryerjes së veprës penale, e cila ndikon drejtpërsëdrejti në rrezikshmërinë e saj, madje i cilëson ato. Si rrjedhojë, në këto raste, kontrabanda mund të kryhet edhe nga grupe të Veprat penale në fushën e doganave nga grupe të armatosura, mund të jetë në kushte trafikimi, sikundër mund të përdorë dhunën në kalimin jashtë apo përmes zonave doganore.

11. Aspekte të përgjithshme të së drejtës penale doganore

Kalimi apo zhvendosja e mjeteve nëpërmjet kufirit doganor, duke përdorur dokumente identifikimi false, apo të shoqëruara me mosdeklarim ose deklarim të pasaktë, duhet konsideruar kryesisht si kontrabandë dhe mashtrime doganore pa shmangie te plota nga pagesat doganore. A është kontrabanda, në raport me shmangien, normë speciale, ndërsa shmangia është normë e përgjithshme. Kontrabanda nëpërmjet kalimit nga territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka si qëllim të vetëm përfitime kriminale Konventa Ndërkombëtare: “Për harmonizimin e rregullave për kontrollin kufitar të mallrave” ekonomike, apo qëllime dhe interesa të tjera që mund të mos kenë lidhje me përfitime ekonomike. Ku duhet të përfshihen krimet në fushën doganore: në të drejtën penale doganore apo në të drejtën penale të përgjithshme. Pamjaftueshmëria e një qasjeje të njëjtë për çështjet e mësipërme, si në teori, ashtu edhe në praktikë, krijon vështirësi në kualifikimin e veprës penale të kontrabandës, madje shpeshherë dhe të padrejtë. Në të njëjtën kohë, kualifikimi i drejtë i krimeve ka njëherazi rëndësi të madhe për veprimtarinë praktike të hetuesve, punonjësve të hetimit paraprak, si dhe gjykatës, për goditjen e veprave penale të kontrabandës me efikasitetin e ligjit dhe kushtetutshmërisë nacionale.⁹

Prandaj edhe mund të vlerësojmë se problemi i harmonizimit të së drejtës penale doganore i RMV-së me atë të vendeve të BE-së si dhe mes vet vendeve të BE-së nuk është aq i thjeshtë, sepse në harmonizimin e Kodit Penal është shfaqur një rezistencë kaq domethënëse për harmonizimin. Ka pasur shumë tentativa deri më sot, tentativat e Komisionit, për

⁹ Shikuar në prizmin teorik lidhur me veprat penale të kontrabandës mund t'i klasifikojmë mendimet apo pikëpamjet e poshtëshënuara si çështje për objekt studimi: Krimi i kontrabandës është një vepër penale kryesisht formale, megjithëse ka raste që kërkon jo vetëm shmangien nga kontrolli doganor, por edhe shmangien nga detyrimet doganore.

të marrë nga shtetet anëtare një vizion konkret rreth sanksioneve doganore, por kanë dështuar. Andaj edhe grupet e strukturuar kriminale dhe individët me pasion dhe ambicie kriminale bëjnë shfrytëzimin maksimal të këtyre zbrazëtirave legjislative në proceset e kriminalitetit doganor.¹⁰

Përfundim

Shërbimi doganor është një autoritet i shtetit, që ka për detyrë mbledhjen e detyrimeve të importit, si dhe kontrollin e mjeteve dhe mallrave që hyjnë-dalin në dhe nga territori doganor i atij vendi. Ai ka lindur dhe është zhvilluar së bashku me shtetin. Madje, nuk mund të konsiderohet aspak gabim nëse mendohet se dogana ka lindur së bashku me tregtinë. Nga ana tjetër, bashkë me doganën dhe kërkesën për vjelje të detyrimeve doganore, duhet të ketë lindur tendenca për të mos paguar detyrimet e caktuara, që në ditët e sotme e quajmë kontrabandë tregtare. Për të parandaluar dhe luftuar krimin e kontrabandës është dashur hartimi i një pakete normash juridike, në të cilat parashikohen figurat konkrete të veprave penale të kontrabandës. Me kalimin e kohës historia ka bërë të vetën. Roli i shërbimit të doganave ka ndryshuar në mënyrë të dukshme, si rezultat i dyfishtë i evolucionarizimit, duke përfshirë rritjen e globalizimit të tregtisë dhe faktorëve të ndryshëm, si sulmet terroriste, trafiku i paligjshëm, krimi i organizuar. Në këtë kuadër, shërbimit doganor i janë ngarkuar me ligj detyra të rëndësishme në luftën kundër trafikut, jo vetëm të mallrave të konsumit, detyrë kjo tradicionale, por edhe në fushën e lëndëve narkotike, të cigareve, të armëve, mallrave me karakter të dyfishtë, në luftën kundër pastrimit të parave, si dhe në sigurinë e porteve, aeroporteve, stacioneve të trenit dhe, në tërësi, të sigurisë kombëtare. Në këtë këndvështrim, vullneti politik, për t'i siguruar administratës së doganës mjete veprimi të jashtëzakonshme në planin juridik, domethënë kompetenca të rëndësishme për të vepruar ndaj personave dhe mallrave që u nënshtrohen kontrolleve, ashtu sikurse dhe kompetencat që mbart për të dënuar mashtruesit e kontrabandistët, në kuadër të një procedure represive specifike dhe veçanërisht efektive, rezulton që e drejta penale doganore në fushën e goditjeve të shkeljeve doganore, të jetë një e drejtë shumë e veçantë nga e drejta penale e përgjithshme. Me interes teorik dhe praktik është gjithashtu edhe studimi i mekanizmave të ndjekjes dhe të sanksioneve në krimet e fushës

¹⁰ Prof.dr. Krstanoski Miladin "Carinska Postapka so osnovi na carinskite kaznivi delikti", Skopje, 2000 god.

doganore, në mënyrë që të kuptojmë veçoritë e tyre, të identifikojmë karakterin, si dhe perspektivat. Mbetet të perceptojmë më mirë ndryshimet e procedimit për krimet në fushën doganore me ato të fushave të tjera. Për të kuptuar mirë veçantinë e mekanizmave të ndjekjes penale dhe të sanksioneve në të drejtën doganore, është e nevojshme të rikujtojmë mutacionet historike, të cilat i kanë dhënë doganës, për një kohë të gjatë, kompetenca të jashtëzakonshme, në mënyrë që të sigurohej efikasiteti dhe shpejtësia e dhënies së dënimeve për veprat doganore

CONCLUSION

The customs service is an authority of the state, which has the task of collecting import duties, as well as controlling the means and goods entering and leaving the customs territory of that country. It was born and raised along with the state. Moreover, it can not be considered at all wrong if it is thought that customs was born together with trade. On the other hand, along with customs and the request for collection of customs duties, there must have been a tendency not to pay certain duties, which nowadays we call commercial smuggling. In order to prevent and fight the crime of smuggling, it was necessary to draft a package of legal norms, which provide for concrete figures of criminal offenses of smuggling. Over time history has taken its toll. The role of the customs service has changed significantly, as a result of dual evolution, including the increasing globalization of trade and various factors, such as terrorist attacks, illegal trafficking, organized crime. In this context, the customs service has been assigned by law important tasks in the fight against trafficking, not only of consumer goods, as a traditional task, but also in the field of narcotics, cigarettes, weapons, dual goods, in the fight against money laundering, as well as in the security of ports, airports, train stations and as a whole, national security. In this point of view, the political will provide the customs administration with extraordinary means of action in the legal field, namely the important powers to act against individuals and legal entities to control, as well as the powers it carries to punish fraudsters, smugglers, in the framework of a specific and particularly efficient repressive procedure, it turns out that the customs criminal law in the field of customs offenses is a very special right from the general criminal law. Of theoretical and practical interest is also the study of mechanisms of prosecution and sanctions in crimes in the field of customs, in order to understand their

features, identify the character, as well as perspectives. It remains to better understand the differences in the processing of crimes in the customs field with those in other areas. To better understand the specificity of the mechanisms of prosecution and sanctions in customs law, it is necessary to recall the historical mutations, which have given customs, for a long time, extraordinary powers, in order to ensure efficiency and speed of punishment for customs offenses.

Recensentë:

Prof. Dr. Bashkim Selmani

Prof. Dr. Berat Aqifi

Bibliografia

1. Arben Dr. Rakipi “Korrupsioni dhe evazioni fiskal”, Tiranë, 2010;
2. Akad. Vllado Kambovski, “E drejta penale pjesa e përgjithshme”, Furkan, Shkup, 2007;
3. Akad. Vllado Kambovski; Koment i kodit të Procedurës Penale”
4. Afrim Dr. Osmani “Kodi penal në RM”, Shkup, Furkan ISM, 2010;
5. Bashkim Dr. Selmani & Mevledin Dr. Mustafi “Sistemet e Sigurisë bashkëkohore”, Shkup 2022,
6. Ignjatović, Đ. Kriminološki značaj tranzicije. u: Kriminalitet u tranziciji: fenomenologija, prevencija i državna reakcija, zbornik, Beograd, 2008: Institut za kriminološka i sociološka istraživanja;
7. Konventa për Krijimin e Këshillit të Kooperimit Doganor (Organizata Botërore e Doganave, Viti 1952); - Mevledin Dr. Mustafi “Personat juridik si pjesëmarrës në kriminalitetin ekonomik” Shkup, 2009;
8. Kambovski, Dr. Vllado, “Reformat penalo-juridike para sfidave të shekullit XXI”, Shkup 2002;
9. Krstanoski Miladin “Carinska Postapka so osnovi na carinskite kaznivi delikti ”, Skopje, 2000 Godina;
10. Krstanoski Miladin, “Carinsko Rabotenje” Ohrid, 2008
11. Dr. M. Llagović i Dr. M. Nikollovski, “Organiziran kriminal i korrupcija”, Shkup, 2009;
12. Konveta e Kiotos, World Customs Organization 2002, Kyoto 2000, The International Convention on the Simplification and Harmonization of Customs procedures);

13. Konventa TIR, “Transport International Routier”, e OKB-së, 1975. 6. Konventa e Nairobi për Harmonizimin e rregullave për kontrollin kufitar të mallrave, Nairobi, 1997;

14. Konventa për Sistemin e harmonizuar e kodifikimit dhe përshkrimit të mallrave,

15. Mevledin Dr.Mustafi “Mastrimet doganore dhe kontrabandimi me keqpërdorimin e dokumentacionit doganor gjatë importit të mallrave”, disertacioni i doktoraturës, Universiteti “Shën Kliment i Ohrit”, 2013.

16. Dr.Alket Hyseni_ Prof Dr. Shamet Shabani „, Krimet në fushën e Doganave. Aspekte të Veprës Penale dhe Kontrabandës” Tiranë, 2014

AKTET JURIDIKE:

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut
2. Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut
3. E Drejta Penale e Republikës së Maqedonisë së Veriut
4. Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut
5. Kodi i procedurës penale të Republikës së Maqedonisë së Veriut

WEB SITE / Librari elektronike

1. www.coustoms.gov.mk
2. www.finance.gov.mk
3. www.pravdiko.gov.mk
4. www.fiscus.fgovbe
5. www.ek.europa.eu/taxationcostums
6. <http://www.interpol.int/>
7. <http://definitions.uslegal.com/c/conditional-contraband/>
(Faqja zyrtare e US Legal Program)